

“Open port 2011”, dhurata simbolike për piktorët e vegjël
Vogëlushët e tre kopshteve të fëmijëve në Durrës kanë marrë sot
dhurata simbolike nga administrata e portit detar.

Fundjavën e kaluar fëmijët e kopshteve “1 Maj”, “1 Qershori” dhe
“Met Hasa” të qytetit bregdetar morrën pjesë me punimet e tyre në
festën “Open port 2011”, që u organizua nga Autoriteti portual i
Durrësit.

Vizatimet dhe pikturat e fëmijëve tërhoqën vëmendjen e të
pranishmëve të shumtë, që ndoqën festën e organizuar për të dytin
vit radhazi në Durrës.

Të ftuar të tjerë në këtë festë ishin Ansambli i fëmijeve artistë të
QKF, valltarë, akrobatë, kllounë, futbollistë, xhonglerë, si dhe
piktorët e vegjël të kopshteve që sot morrën dhuratat simbolike.

“Open port” këtë vit morri pamjen e një aktiviteti argëtues
shumëplanësh, që pati synim të kthejë në protagonistë të gjitha
grupmoshat pjesmarrëse në Festën e madhe.

“Open port” do të jetë një veprimtari tradicionale e përvitshme.



